



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 123

Tiranë – E enjte, 2 korrik 2020

PËRMBAJTJA

Faqe

Ligj nr. 55/2020 datë 30.4.2020	Për shërbimet e pagesave.....	7363
Vendim i Kuvendit nr. 29/2020, datë 25.6.2020	Për mosmiratimin e projektligjit “Për përjashtimin nga emërimi, zgjedhja në organe drejtuese dhe punësimit në funksione publike, shtetërore dhe politike të ish-funksionarëve, nëpunësve që kanë ushtruar detyra drejtuese në periudhën 28.11.1944 deri më 8.12.1990”.....	7406
Vendim i Kuvendit nr. 30/2020, datë 25.6.2020	Për rrëzimin e dekretit nr. 11 493, datë 1.6.2020, të Presidentit të Republikës, “Për kthimin e ligjit nr. 55/2020 ‘Për shërbimet e pagesave’”..	7406
Vendim i Kuvendit nr. 32/2020, datë 25.6.2020	Për ngritjen e Nënkomisionit për Monitorimin e Zbatimit të Buxhetit të Shtetit dhe Kontrollin e tij, në përbërje të Komisionit të Përhershëm Parlamentar për Ekonominë dhe Financat.....	7406
Rezolutë e Kuvendit datë 25.6.2020	Për raportin vjetor të Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2019.....	7407
Rezolutë e Kuvendit datë 25.6.2020	Për raportin vjetor të Këshillit të Lartë të Prokurorisë për vitin 2019.....	7410
Rezolutë e Kuvendit datë 25.6.2020	Për vlerësimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë për vitin 2019.....	7412
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 493, datë 24.6.2020	Për përcaktimin e masës së financimit, në buxhetin e vitit 2020, për bashkësitë fetare, që kanë nënshkruar marrëveshje me Këshillin e Ministrave.....	7416
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Financave dhe Ekonomisë, ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 22, datë 5.6.2020	Për mënyrën e ndërveprimit të programeve sociale të strehimit me shërbimet sociale të punësimit, arsimit dhe kujdesit shëndetësor.....	7417



datës 5.12.2019 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë me zgjedhjen e kandidatit të renditur i pari nga vlerësimi i Këshillit, zoti Olsian Çela, Prokuror i Përgjithshëm.

Bazuar sa më sipër, Kuvendi i Shqipërisë nxit Këshillin e Lartë të Prokurorisë:

1. Të veprojë me ritme të shpejta për adresimin e zgjidhjeve të problematikave në sistemin e prokurorisë.

2. T'i kushtojë rëndësi komunikimit me publikun për veprimtarinë e Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

3. Të forcojë bashkëpunimin me organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë dhe institucionet e tjera shtetërore në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi për të gjitha proceset që ndikojnë në zbatimin e duhur dhe efektiv të reformës në drejtësi.

4. Të informojë vazhdimisht Kuvendin e Shqipërisë për problematikat e hasura në sistemin e prokurorisë duke rekomanduar edhe zgjidhjet përkatëse.

Kuvendi i Shqipërisë për vitin 2020 kërkon nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë:

1. Vijimin e procedurave për përzgjedhjen e prokurorëve të tjerë të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për të bërë të mundur plotësimin e vendeve të lira në këtë institucion.

2. Përshpejtimin e procedurave për emërimin e drejtuesve të prokurorive pranë gjykatave të rretheve gjyqësore, sipas parashikimeve ligjore në fuqi, duke u dhënë fund komandimeve të përkohshme.

3. Bashkërendimin e punës, si dhe shkëmbimin e vazhdueshëm të informacioneve me Prokurorin e Përgjithshëm, si dhe Shkollën e Magjistraturës, me qëllim përmbushjen me efikasitet të detyrave kushtetuese dhe ligjore të të tria organeve, në veçanti me Prokurorin e Përgjithshëm, për zbatimin efektiv të instituteve të reja të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale.

4. Bashkëpunimin me Shkollën e Magjistraturës për verifikimin me prioritet të kandidatave, të cilat mund të pranohen në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës për vitin 2020–2021, si dhe trajnimin vazhdueshëm të prokurorëve në detyrë.

5. Marrjen e masave për emërimin sa më shpejt të magjistratëve të profilin prokuror, që kanë

përfunduar Shkollën e Magjistraturës, për të cilët ka përfunduar verifikimi i pasurisë dhe figurës.

6. Vijimin me ritme të shpejta të punës në hartimin dhe dorëzimin e raporteve të aftësive profesionale të prokurorëve pranë organeve të rivlerësimit kalimtar.

7. Përmbylljen e paketës së plotë me akte nënligjore normative dhe rregullatore, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar dhe ligjeve të tjera të reformës në drejtësi, veçanërisht miratimin e akteve nënligjore për rregullat e brendshme të funksionimit të Këshillit, si dhe rregullat për administrimin e karrierës së prokurorëve në përputhje me meritat profesionale të secilit.

8. Forcimin e marrëdhënieve institucionale me Inspektoratin e Lartë të Drejtësisë, me qëllim trajtimin në afate të arsyeshme të procedimeve disiplinore për prokurorët.

9. Vijimin e dhënies së opinionëve dhe vlerësimeve për përmirësimet ligjore në përputhje me përcaktimet e nenit 187 të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 25.6.2020.

**REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË
ENTIT RREGULLATOR TË ENERGJISË
PËR VITIN 2019**

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke njohur Entin Rregullator të Energjisë, si rregullatori i vetëm dhe i pavarur për mbikëqyrjen e funksionimit të tregut të energjisë elektrike e të gazit natyror, si dhe për ruajtjen e ekuilibrit ndërmjet interesave të konsumatorëve, shtetit dhe sipërmarrësve në këtë sektor;

Duke theksuar se me gjithë vonesat e procesit të ndarjes së OSHEE-së, që prej 1 janarit të këtij viti tri shoqëritë e krijuara, konkretisht Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sh.a. (OSSH sh.a.), Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a. (FSHU sh.a.) dhe Furnizuesi i Tregut të Lirë sh.a. (FTL sh.a.) funksionojnë ligjërisht të ndara;

